



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 175

5 nëntor

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 974, datë 28.10.2013	Për një shtesë fondesh në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencinë e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI).....	7593
Vendim i KM nr. 976, datë 25.10.2013	Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për asistencën teknike për projektin e rrugëve dytësore dhe lokale nr. 2 - mbështetje për zbatimin dhe qëndrueshmërinë.....	7593
Vendim i KM nr. 977, datë 25.10.2013	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Tajlandës, për përjashtimin nga vizat për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.....	7603

VENDIM

Nr. 974, datë 28.10.2013

PËR NJË SHITESË FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT DHE AGJENCINË E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT (AKTI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2013, për mbulimin e shpenzimeve të transferimit të zyrave, të bëhet një shtesë fondesh për institucionet e mëposhtme:

a) Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit t’i shtohet fondi prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh;

b) Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh.

2. Efektet financiare sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 976, datë 25.10.2013

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE DHE BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE, PËR ASISTENCËN TEKNIKE PËR PROJEKTIN E RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE
NR. 2 - MBËSHTETJE PËR ZBATIMIN DHE QËNDRUESHMËRINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për asistencën teknike për projektin e rrugëve dytësore dhe lokale nr. 2 - mbështetje për zbatimin dhe qëndrueshmërinë, për shumën 1 250 000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) euro, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

7593



BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE

WB1-ALB-TRA-01 No2
SERAPIS 20070519

ASISTENCË TEKNIKE PËR SHQIPËRINË
PROJEKTI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE NR. 2 –
MBËSHTETJE PËR ZBATIMIN DHE QËNDRUESHMËRINË
(ASISTENCË TEKNIKE SIPAS KUADRIT TË INVESTIMEVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR)

MARRËVESHJE FINANÇIMI
NDËRMJET BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE
LUKSEMBURG
TIRANË

Kjo marrëveshje (më poshtë “marrëveshja”) lidhet ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve me zyrën e saj kryesore në 100 Boulevard Konrad Adenauer, Luksemburg, Dukati i Madh i Luksemburgut, i përfaqësuar nga z. Dominique Courbin, Shefi i Divizionit, Operacionet Huadhënëse MA-3 dhe ..., Drejtoria Juridike, më poshtë quhet “Banka” ose “EIB” nga njëra anë, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministri i Financave, z. Ridvan Bode, më poshtë quhet “Përfituesi”, nga ana tjetër. (Banka dhe Përfituesi më poshtë quhen edhe “pala” dhe së bashku “palët”).

Ndërsa:

1. Banka ka nënshkruar më 4 qershor 2010 një kontratë financiare me titull “Projekti i rrugëve dytësore dhe lokale” me Republikën e Shqipërisë, në pajtim me të cilën ajo ka rënë dakord t’i japë hua Republikës së Shqipërisë 50 milionë euro për të bashkëfinancuar zbatimin e një projekti (projekti) që është pjesë e një programi në vazhdim për rehabilitimin e rrugëve dytësore dhe lokale në Shqipëri. Projekti bashkëfinancohet, gjithashtu, nga EBRD-ja.

2. Përfituesi ka kërkuar asistencën financiare nga Kuadri i Investimeve i Ballkanit Perëndimor (WBIF), me qëllim që Fondi Shqiptar i Zhvillimit (ADF) të prokurojë mbështetje si asistencë teknike për zbatimin e projektit. Komiteti drejtues i WBIF-së ka aprovuar alokimin e fondeve për këtë asistencë teknike. Një marrëveshje e parë financimi është nënshkruar ndërmjet Bankës dhe Përfituesit më 28 shkurt 2011, për një shumë prej 1 milion eurosh për të përgatitur një projekt të detajuar të rrugëve sipas projektit. Brenda objektit të asistencës teknike të aprovuar nga WBIF-ja, është rënë dakord të financohen shërbimet shtesë të konsulencës për të dhënë mbështetje zbatimi dhe mbështetje qëndrueshmërie për projektin me një shumë prej 1.25 milionë eurosh që duhet të jepen nga Fondi i Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor “Buxheti WBIF/EWBIF”.

3. Banka ka rënë dakord të lidhë një marrëveshje të dytë financimi me Përfituesin me qëllim që ADF-ja të prokurojë shërbimet shtesë të konsulencës për mbështetjen e zbatimit dhe mbështetjen e qëndrueshmërisë (shërbimet e konsulencës), që përshkruhen më hollësisht në përshkrimin teknik të parashikuar në grafikun A (përshkrimi teknik).

4. ADF-ja do të lidhë kontrata konsulence (kontratat e konsulencës) me konsulentët (konsulentët) për të kryer shërbimet e konsulencës.

5. Referencat te nenet, pjesa hyrëse, grafikët dhe anekset janë referenca përkatësisht te nenet, pjesa hyrëse, grafikët dhe anekset e kësaj marrëveshjeje.

6. Të drejtat dhe detyrimet reciproke të palëve parashikohen në këtë marrëveshje.

Kështu bihet dakord si më poshtë:

Neni 1

Financimi i asistencës teknike

1.01 Shuma e grantit

Sipas termave dhe kushteve të përcaktuara më poshtë në këtë marrëveshje, Banka dëshiron t'i ofrojë Përfituesit dhe Përfituesi e pranon këtë, fondet (grantin) me një shumë maksimale prej 1.250.000 eurosh (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë euro), të cilat do të financohen plotësisht nga Kuadri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor, që do të përdoren ekskluzivisht për shërbimet e konsulencës.

Granti nuk do të përdoret për të financuar TVSH-në për shërbimet e konsulencës.

1.02 Procedurat e pagesës

Granti do t'i livrohët Përfituesit me kërkesë dhe në pajtim me kushtet e nenit 1.04 (kushtet e pagesës).

Banka e livron grantin deri në 4 transhe (secili një "transh"). Shuma e transhit të parë është 400.000 euro. Shuma e çdo transhi pasues, nëse nuk është balanca e patërhequr e grantit, është një minimum prej 200.000 eurosh. Herë pas here deri më 31 dhjetor 2014 apo një datë tjetër që mund të aprovojë Banka, Përfituesi, nëpërmjet ADF-së, mund t'i paraqesë Bankës një kërkesë livrimi (kërkesë livrimi), në përmbajtje në formën e bashkëngjitur si grafiku B.

Çdo kërkesë livrimi, së bashku me çdo provë të kërkuar sipas nenit 1.04 (kushtet e pagesës), duhet të merren nga Banka të paktën tridhjetë (30) ditë para datës së livrimit të kërkuar nga ADF-ja. Përfituesi njuh që pagesa e bërë atij përbën një livrim sipas parashikimit të këtushëm.

Përfituesi është përgjegjës për t'i ofruar ADF-së fondet e livruara sipas parashikimeve të këtushme. Ministria e Financave i transferon fondet e livruara tek ADF-ja nëpërmjet një marrëveshjeje transferimi.

1.03 Monedha e pagesës

Të gjitha pagesat e kërkuara në lidhje me këtë marrëveshje bëhen në pajtim me dispozitat e parashikuara në nenin 2 (monedha e zbatueshme e pagesës) të këtushëm.

1.04 Kushtet e pagesës

A. Livrimi i parë në pajtim me nenin 1.02 është i kushtëzuar nga marrja nga Banka në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, në ose para datës që bie tridhjetë (30) ditë para datës së livrimit të kërkuar, të origjinaleve ose kopjeve të vërtetuara të kontratave të nënshkruara të konsulencës.

B. Çdo livrim, përveç të parit, i nënshtrohet, gjithashtu, marrjes nga Banka, jo më pak se tridhjetë (30) ditë para datës së livrimit të kërkuar, të provave shkresore të pranueshme për Bankën, që ADF-ja ka bërë shpenzime të kualifikuara (shpenzime të kualifikuara) në lidhje me pjesën e shërbimeve të konsulencës që financohen nga Banka, brenda ditës së 180-të që bie pas datës së livrimit të specifikuar në kërkesën e livrimit, në një shumë të paktën të barabartë me shumën e: i) 100% të shumave të të gjitha transheve të livruara më parë; dhe ii) 100% të shumës së transhit që do të livrohët. "Shpenzime të kualifikuara" janë shpenzimet (zbritur taksat dhe detyrimet e pagueshme nga Përfituesi ose ADF-ja) të bëra nga ADF-ja për kontratat e konsulencës, në lidhje me artikujt e specifikuar në përshkrimin teknik si të përshtatshëm për financim nga granti, që janë objekt i kontratës ose kontratave të nënshkruara sipas termave të pranueshëm për Bankën, duke pasur parasysh botimin më të fundit të "Udhëzimeve të Bankës për Prokurimin", të publikuar në faqen e saj të internetit. Për qëllimet e llogaritjes së ekuivalentit të euros të çdo shume të shpenzuar në një monedhë tjetër, Banka zbaton normën e këmbimit të referencës të llogaritur dhe të publikuar për atë monedhë nga Banka Evropiane Qendrore, për atë datë që bie pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së livrimit që vendos Banka (ose, nëse nuk ka një normë të tillë, norma ose normat përkatëse të këmbimit që mbizotërojnë në një treg financiar të zgjedhur në mënyrë të arsyeshme nga Banka).

Çdo livrim i bërë paraprakisht për shpenzimet i nënshtrohet marrjes nga Banka brenda 180 ditëve nga data e livrimit, të kopjeve të faturave të paguara nga ADF-ja konsulentëve. Kopjet e faturave shoqërohen me një raport nga një audit i pavarur i jashtëm për këto fatura, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën. Kostoja e këtij auditi të jashtëm, sipas parashikimit në nenin 1.04, është një shpenzim i përshtatshëm sipas grantit. Nëse një pjesë e provave të dhëna nuk është e pranueshme për



Bankën, Banka mund të livrojë proporcionalisht më pak se shuma e kërkuar, pa cenuar nenin 1.02.

Provat shkresore, duke përfshirë faturat të paraqitura Bankës për përmbushjen e kushteve të parashikuara sipas këtij neni 1.04 (kushtet e pagesës) nuk paraqiten më shumë se një herë për livrim.

Çdo livrim është i kushtëzuar nga marrja nga Banka në ose para datës që bie 15 ditë para datës së livrimit të kërkuar, të pagesës së bërë nga EWBIF Bankës për këtë qëllim.

Çdo livrim bëhet në atë llogari të veçantë të Përfituesit në Bankën e Shqipërisë që Përfituesi i njofton me shkrim drejtuar Bankës jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së livrimit të planifikuar (me kodin IBAN ose me formatin e përshtatshëm në pajtim me praktikën bankare lokale).

1.05 Anulimi i grantit

Banka mund të anulojë pjesën e palivruar të grantit në çdo kohë pas ndodhisë së një ngjarjeje të përmendur në nenin 7 (shkelja e detyrimit).

Pjesa e palivruar e grantit konsiderohet të jetë e anuluar nëse parapagesa kërkohet sipas nenit 7 (shkelja e detyrimit).

1.06 Pezullimi i livrimit

Pa cenuar nenin 1.05 (anulimi i grantit) dhe 7 (shkelja e detyrimit), Banka në çdo kohë mund të pezullojë çdo livrim të grantit pas ndodhisë së një ngjarjeje të përmendur në nenin 7 (shkelja e detyrimit). Banka mund të vazhdojë pezullimin për sa kohë që ajo është e mendimit që ngjarja vazhdon.

Neni 2

Monedha e zbatueshme e pagesës

- a) Banka do t'i bëjë të gjitha livrimet sipas kësaj marrëveshjeje në euro.
- b) Çdo shumë që Përfituesit i kërkohet nga Banka sipas kësaj marrëveshjeje, paguhet në euro.
- c) Një deklaram me shkrim nga Banka në lidhje me shumën e plotë që kërkohet të paguhet nga Përfituesi, përveç në rastet e gabimeve të dukshme, është provë përfundimtare për shumën e kërkueshme.

Neni 3

Pagesat

3.01 Pagesat për Përfituesin

Përfituesi, nëpërmjet Ministrisë së Financave, hap një llogari të veçantë për pagesën e grantit (llogaria). Banka çdo livrim e bën në llogari, hollësitë e së cilës tregohen nga ADF-ja në kërkesën e livrimit. Llogaria, gjithmonë dhe në çdo aspekt, përdoret ekskluzivisht për qëllimet e grantit.

Neni 4

Angazhime të veçanta

4.01 Përdorimi i shumave të grantit

Përfituesi përdor dhe merr masa që ADF-ja të përdorë shumat e grantit vetëm për financimin e shërbimeve të konsulencës të përshkruara në grafikun A - Përshkrimi teknik.

4.02 Kontratat me konsulentët

Përfituesi merr masa që ADF-ja të mos anulojë, ndryshojë ose pezullojë kontratat e konsulencës pa pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës.

Kontratat e konsulencës shprehen ose në euro, ose në monedhën zyrtare lokale të Republikës së Shqipërisë (ALL), ose në një monedhë të tregtueshme ndërkombëtare.

4.03 Kostoja e shtuar e shërbimeve të konsulencës

Nëse kostoja për përfundimin e shërbimeve të konsulencës e kalon buxhetin e treguar në kontratat e konsulencës, Përfituesi e merr financimin për të financuar koston shtesë pa iu drejtuar Bankës, për të përfunduar shërbimet e konsulencës në pajtim me përshkrimin teknik. Në një rast të tillë, Përfituesi i paraqet Bankës për konsultim paraprak në kohën e duhur parashikimin e këtij financimi shtesë.

4.04 Zbatimi i shërbimeve të konsulencës

Përfituesi, nëpërmjet ADF-së, siguron që shërbimet e konsulencës, që mund të ripërcaktohen herë pas here me aprovimin e Bankës, të kryhen dhe përfundohen brenda afatit të parashikuar në kontratat e konsulencës ose në një moment tjetër që mund të aprovohet nga Banka.

4.05 Zgjedhja e konsulentëve

Përfituesi merr masa që ADF-ja:

a) të zgjedhë konsulentët në pajtim me “Udhëzimin për prokurime” të EIB-së, që ndryshohet herë pas here;

b) të kontaktojë Bankën për të marrë aprovimin paraprak me termat dhe kushtet e kontratave të konsulencës (duke përfshirë listën e shkurtër, termat e referencës, procedurën e zbatueshme të prokurimit, dokumentet e tenderit para fillimit dhe dhënien e kontratës pas procesit të tenderit).

Banka rezervon të drejtën të caktojë një vëzhgues në komitetin e vlerësimit të tenderit për zgjedhjen e konsulentëve.

4.06 Detyrimet për bashkëpunim

Përfituesi merr masa që ADF-ja të sigurojë që punonjësit e saj përkatës të bashkëpunojnë gjithmonë me Bankën dhe konsulentët në lidhje me dhënien e shërbimeve të konsulencës.

4.07 Asistenca për rregulloret lokale

Konsulentët mund të kërkojnë asistencën e Përfituesit ose të ADF-së për të marrë kopje të ligjeve, rregulloreve dhe informacionin që mund të ndikojë konsulentët në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kontratave të konsulencës.

Në pajtim me ligjet dhe rregulloret e punës nga të huajt në Shqipëri, Përfituesi bën dhe siguron që ADF-ja të bëjë përpjekjet më të mira për të siguruar që punonjësit e konsulentit dhe personat e varur prej tyre të përftojnë vizat dhe lejet e kërkuara, duke përfshirë lejet e punës dhe të qëndrimit, sipas rastit.

4.08 Angazhimi për integritet

Përfituesi garanton dhe merr përsipër se as ai dhe as ADF-ja nuk ka kryer dhe asnjë person në dijeninë e tij, nuk ka kryer ndonjë prej veprimeve të mëposhtme dhe që ai dhe ADF-ja nuk do të kryejnë, dhe asnjë person, me pëlqimin e tyre dhe dijeninë paraprake, nuk do të kryejë ndonjë veprim të tillë, që është:

i) ofrimi, dhënia, marrja, kërkimi ose avantazhi i parregullt për të ndikuar në veprimin e ndonjë personi që ka një post publik ose funksion apo drejtor, ose punonjës i një autoriteti publik apo ndërmarrjeje publike, ose një drejtor apo nëpunës i një organizate ndërkombëtare publike në lidhje me një proces prokurimi ose në zbatim të një kontrate në lidhje me ato elemente të shërbimeve të konsulencës, të përshkruara në përshkrimin teknik; ose

ii) një veprim, i cili ndikon në mënyrë të parregullt ose synon të ndikojë në mënyrë të parregullt procesin e prokurimit ose zbatimin e shërbimeve të konsulencës në dëm të ADF-së, duke përfshirë bisedat e fshehta ndërmjet ofertuesve.

Përfituesi njofton Bankën nëse ai ose ADF-ja vihen në dijeni të një fakti ose informacioni që tregon kryerjen e një prej këtyre veprimeve dhe lehtëson çdo hetim që Banka mund të bëjë në lidhje me një veprim ose sjellje të tillë.

4.09 Certifikimi i shërbimeve të konsulencës

Përfituesi bie dakord që pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje të lejojë çdo person, duke përfshirë, por pa u kufizuar në konsulentët e jashtëm, të emëruar herë pas here nga Banka, të kryejë certifikimin e aspekteve të ndryshme të shërbimeve të konsulencës të kryera nga konsulentët.

Neni 5

Monitorimi dhe aprovimi i raporteve

5.01 Në lidhje me shërbimet e konsulencës, Përfituesi merr masa që ADF-ja:

a) t'i komunikojë me shkrim Bankës çdo koment që mund të ketë për rezultatin e shërbimeve të konsulencës;



b) të njoftojë menjëherë Bankën për çdo fakt ose ngjarje në dijeni të ADF-së që mund të paragjykojë ose ndikojë thelbësisht përfundimin e shërbimeve të konsulencës;

c) të ndjekë zbatimin e shërbimeve të konsulencës, të aprovojë të gjitha raportet (që përmenden në përshkrimin teknik në grafikun A, pasi t'i ketë dhënë Bankës mundësinë për të rishikuar raportet, t'i dërgojë një kopje të versionit përfundimtar të raporteve përfundimtare Bankës dhe t'i japë Bankës një raport semestral mbi përparimin e shërbimeve të konsulencës;

d) të bëjë përpjekjet e tij të arsyeshme për të marrë lejen për përfaqësuesit e autorizuar të Bankës për të komunikuar dhe nëse është e nevojshme të vizitojnë një ose të gjithë konsulentët për të marrë atë informacion që Bankës i duhet në lidhje me përparimin e shërbimeve të konsulencës; dhe

e) t'i komunikojë një raport përfundimi të pranueshëm për Bankën brenda 2 muajve nga përfundimi i shërbimeve të konsulencës.

Raporte specifike për zbatimin e shërbimeve të konsulencës të përgatitura nga ADF-ja dhe/ose ato të përgatitura nga konsulentët duhet të kenë njoftimin e mëposhtëm: “Ky dokument është përgatitur me asistencën financiare të Fondit Evropian të Përbashkët për Ballkanin Perëndimor, brenda Kuadrit të Investimeve në Ballkanin Perëndimor”. Mendimet e shprehura në të janë ato të (emri i autorit) dhe në këtë mënyrë nuk mund të merren sikur reflektojnë mendimin zyrtar të kontributorëve të Fondit Evropian të Përbashkët për Ballkanin Perëndimor ose të Bankës apo EBRD-së, si bashkëmenaxherë të Fondit Evropian të Përbashkët për Ballkanin Perëndimor.

5.02 Në lidhje me Përfituesin dhe ADF-në

a) Përfituesi përgjithësisht vë në dijeni Bankën për çdo fakt që mund të parandalojë përmbushjen e një detyrimi të Përfituesit ose ADF-së sipas kësaj; dhe

b) Përfituesi merr masa që ADF-ja t'i paraqesë Bankës çdo dokument të kërkuar nga kjo e fundit, duke përfshirë, pa u kufizuar, raportet e auditit ose pasqyrat e llogarive.

5.03 Vizitat

Përfituesi njuh që Banka mund të jetë e detyruar të deklarojë dokumente të tilla, në lidhje me ADF-në dhe konsulentët, para Gjykatës së Auditëve të Komuniteteve Evropiane (më poshtë “Gjykata”), nëse është e nevojshme për përmbushjen e detyrës së Gjykatës në pajtim me të drejtën e Komunitetit Evropian.

Përfituesi merr masa që ADF-ja të lejojë çdo person të caktuar nga Banka, i cili mund të shoqërohet nga përfaqësuesit e Bankës të vizitojë ADF-në, konsulentët dhe të kryejnë ato kontrole që ata dëshirojnë. Për këtë qëllim, Përfituesi siguron që ADF-ja t'i pajisë ata ose të marrë masa që ata të pajisen me të gjithë asistencën e nevojshme. Me rastin e një vizite të tillë, përfaqësuesit e Gjykatës mund t'i kërkojnë Përfituesit dhe/ose ADF-së të paraqesin dokumente që futen në sferën e paragrafit të parë të këtij neni.

Neni 6

Detyrime fiskale

6.01 Tatimet, detyrimet dhe tarifat

Përfituesi paguan të gjitha taksat, detyrimet dhe tarifat të çdo natyre, duke përfshirë taksën e pullës dhe tarifat e regjistrimit, që rrjedhin nga nënshkrimi ose zbatimi i kësaj marrëveshjeje dhe dokumentet në lidhje me të, në pajtim me ligjet e zbatueshme lokale. Në rastin e shlyerjes së grantit ose një pjese të tij në pajtim me nenin 7 (shkelja e detyrimit), të gjitha shumat e pagueshme nga Përfituesi për Bankën paguhet pa zbritur asnjë taksë.

6.02 Detyrime të tjera

Përfituesi siguron që ADF-ja të mbulojë detyrimet e veta profesionale dhe bankare dhe çdo komision transferte apo këmbimi, të shkaktuar me nënshkrimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe të kontratave të konsulencës.

Neni 7
Shkelja e detyrimit

7.01 E drejta për të kërkuar shlyerjen

Përfituesi e shlyen grantin menjëherë pas kërkesës së bërë nga Banka, në rastin e një prej rrethanave të mëposhtme:

a) nëse Përfituesi ose ADF-ja nuk përmbush një prej detyrimeve të caktuara atyre, brenda një kohe të arsyeshme, të specifikuar në njoftimin e dërguar nga Banka për Përfituesin ose ADF-në, që kërkon përmbushjen;

b) nëse një informacion i dhënë Bankës nga ose në emër të Përfituesit ose ADF-së në lidhje me negociatat e kësaj marrëveshjeje del i pasaktë në një aspekt material të caktuar;

c) nëse Banka është e mendimit që Përfituesi ose ADF-ja ka vepruar në përmbushjen e detyrimeve të saj haptazi me neglizhencë, mashtrim, abuzim ose sjelle dashakeqe;

d) nëse Banka pezullon, anulon ose kërkon parapagimin e një huaje të dhënë Përfituesit ose nëse një kontratë e lidhur ndërmjet Bankës dhe Përfituesit deklarohet e pavlefshme ose e pazbatueshme nga një gjykatë kompetente;

e) nëse Përfituesi ose ADF-ja është në vonesë për pagesën korrekte të një shume të kërkueshme nga Banka, sipas një marrëveshjeje të ndryshme nga kjo marrëveshje;

f) nëse një fakt i përcaktuar në pjesën hyrëse ndryshon ose pushon së ekzistuari dhe nëse interesat e Bankës sipas mendimit të saj cenohen.

7.02 Të drejta të tjera ligjore

Neni 7.01 nuk kufizon asnjë të drejtë tjetër të Bankës për të kërkuar shlyerjen e grantit.

Neni 8
Detyrimet e palëve

Përfituesi zhdëmton Bankën për çdo dëm, humbje, kosto dhe shpenzim që pësohen ose bëhen nga Banka, ndër të tjera, si rezultat i një veprimi ose mosveprimi të kryer nga ai ose ADF-ja, nga mosrespektimi i ADF-së i një prej detyrimeve të saj përkatëse të parashikuara në këtë marrëveshje, për shkak të neglizhencës së saj të hapur, të një veprimi abuzimi të qëllimshëm ose një veprimi mashtrues.

Banka nuk detyrohet kundrejt Përfituesit ose ADF-së për shkak të një veprimi ose mosveprimi të konsulentëve, ose për mosdhënien nga konsulentët të shërbimeve të konsulencës në pajtim me kontratat e konsulencës. Megjithatë, Përfituesi ose ADF-ja mund t'i kërkojnë Bankës të ndryshojë disa ose të gjithë konsulentët, nëse puna e tyre sipas mendimit të Përfituesit ose ADF-së duket e papranueshme ose nëse konsulentët kryejnë veprime ose mosveprime të padëshirueshme.

Banka bën përpjekjet e saj të arsyeshme për të përmbushur kërkesat nga ana e Bankës në pajtim me kontratat e konsulencës.

Përfituesi nuk detyrohet kundrejt Bankës, konsulentëve ose palëve të tjera për shkak të një veprimi ose mosveprimi të konsulentëve ose për mosdhënien nga konsulentët të shërbimeve të konsulencës në pajtim me kontratat e konsulencës.

Neni 9
Konfidencialiteti

Banka do të trajtojë çdo informacion të dhënë nga Përfituesi ose ADF-ja në përmbushje të detyrimeve të këtyre të fundit në pajtim me rregullat e saj normale të konfidencialitetit.



Neni 10 Ligji dhe juridiksioni

10.01 Ligji

Kjo marrëveshje dhe hartimi, interpretimi dhe vlefshmëria e saj rregullohen nga ligjet e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

10.02 Juridiksioni

Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me këtë marrëveshje i paraqiten juridiksionit të Tribunal d'Arrondissement të Luksemburgut dhe palët i nënshtrohen në mënyrë të pakthyeshme juridiksionit të Tribunal d'arrondissement të Luksemburgut.

Palët e kësaj marrëveshjeje heqin dorë nga çdo imunitet ose e drejtë për të kundërshtuar juridiksionin e Tribunal d'Arrondissement të Luksemburgut. Çdo vendim i Tribunal d'Arrondissement të Luksemburgut i dhënë në pajtim me këtë nen, është përfundimtar dhe detyrues për palët pa kufizim ose rezervë.

10.03 Mosheqja dorë

Asnjë mosushtrim apo vonesë nga Banka në ushtrimin e një prej të drejtave të saj sipas kësaj marrëveshjeje nuk interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë.

Neni 11 Dispozita përfundimtare

11.01 Njoftimet

Njoftimet dhe komunikimet e tjera të bëra (të ndryshme nga ato që rrjedhin nga proceset gjyqësore) drejtuar Bankës ose Përfituesit dërgohen me faks, telegram, letër të regjistruar ose letër të porositur, drejtuar atyre në adresat e treguara më poshtë, ose në ato adresa të tjera që i kanë njoftuar më parë tjetrës me shkrim si adresë të re për këtë qëllim:

Për Bankën:	European Investment Bank Lending Operations MA-3/Project Directorate 100, Boulevard Konrad Adenauer L-2950 Luxembourg
Për Përfituesin:	Ministri i Financave Ministria e Financave Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 4 Tirana/Shqipëri Nr. i faksit: +355 4 222 8494
Për dijeni:	Fondit Shqiptar të Zhvillimit (ADF): z. B. Beci Drejtor Ekzekutiv Rruga "Sami Frashëri", nr. 10 Tirana/Shqipëri Nr. i faksit: +355 4 234 885

11.02 Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi me përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore nga Përfituesi dhe njoftimin e saj drejtuar Bankës.

11.03 Pjesa hyrëse, grafikët dhe anekset

Pjesa hyrëse dhe grafikët përbëjnë pjesë të kësaj marrëveshjeje:

Grafiku A
Grafiku B

Në dëshmi të kësaj, palët kanë realizuar nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje në emër të tyre në tri kopje origjinale në gjuhën angleze.

Nënshkruar në emër të
BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE

.....
Drejtorja Juridike

Z. Dominique Courbin
Shef Divizioni

Grafiku A - Përshkrimi teknik
Kërkesë livrimi

Nënshkruar në emër të
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Z. Ridvan Bode
Ministri i Financave

GRAFIKU A

PËRSHKRIM TEKNIK ASISTENCË TEKNIKE PËR SHQIPËRINË PROJEKTI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE NR. 2: MBËSHTETJE PËR ZBATIMIN DHE QËNDRUESHMËRINË

Granti do të financojë shërbimet e mëposhtme:

1. Mbështetje për zbatimin - asistencë teknike për të këshilluar menaxhimin e përgjithshëm, planifikimin, raportimin, prokurimin, monitorimin dhe vlerësimin e projektit.

2. Mbështetje për qëndrueshmërinë - asistencë teknike për këshillimin e ADF-së dhe komunave për menaxhimin dhe financimin e mirëmbajtjes së rrugëve lokale për të ndihmuar në sigurimin e qëndrueshmërisë të sendeve të financuara nga huaja përkatëse.

3. Shërbime të tjera - shërbime të tjera të projektimit, mbikëqyrjes dhe monitorimit drejtpërdrejt në lidhje me projektin.

Granti do të financojë komponentin sipas artikullit 3 të mësipërm, vetëm në masën që mbeten fonde të disponueshme pas përfundimit me sukses të komponentëve, sipas artikujve 1 dhe 2 më sipër. Palët në çdo rast bien dakord dhe më pas rishikojnë rregullisht objektin përfundimtar të alokimit të grantit. Ky përshkrim teknik mund të ndryshohet me kusht që ndryshimet të përfshihen brenda formularit të aplikimit të projektit WB1-ALB-TRA-01, siç aprovet nga komiteti drejtues i WBIF-së. Ndryshimet i nënshtrohen aprovimit të EIB-së, të cilat ia njoftojnë ato me shkrim ADF-së dhe për dijeni Përfituesit, pa pasur nevojën e një ndryshimi formal me shkrim të kësaj marrëveshjeje financimi.

4. Data e përfundimit për përdorimin e grantit është 31 dhjetor 2014.

5. Kostoja e auditit të jashtëm, sipas parashikimit të nenit 1.04, është shpenzim i përshtatshëm sipas grantit.



GRAFIKU B

KËRKESE LIVRIMI

Jeni të lutur të kryeni pagesën e mëposhtme:

Datë:

Emri i marrëveshjes së financimit:

**Asistencë teknike për Shqipërinë, projekti i rrugëve dytësore dhe lokale nr. 2:
Mbështetje për zbatimin dhe qëndrueshmërinë
Grand për asistencë teknike sipas kuadrit të investimeve të Ballkanit Perëndimor**

Marrëveshje financimi
Data e nënshkrimit:

WB1-ALB-TRA-01 No2

Numri i marrëveshjes FI
(sipas rastit):

Burimi i financimit

Buxheti WBIF / EWBJF

Shuma në EURO e kërkuar

EURO	Shuma

Data e propozuar e livrimit:

Rezervuar për EIB-në	Buxheti WBIF/EWBJF
	EURO
Shuma e përgjithshme e plotë	1 250 000
Paguar në datë:	
Balanca për pagesë:	
Pagesa faktike:	
Balanca pas pagesës:	

Llogaria e përfituesit që do të kreditohet:

Llogaria nr.:

(jeni të lutur, jepni formatin IBAN)

BIC Code nr.:

Emri dhe adresa e Bankës:

Jeni të lutur të kaloni informacionin tek:

Emri(at) dhe nënshkrimi(et) e autorizuar të Përfituesit

VENDIM
Nr. 977, datë 25.10.2013

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË TAJLANDËS, PËR
PËRJASHTIMIN NGA VIZAT PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË
SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Tajlandës, për përjashtimin nga vizat për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
MBRETËRISË SË TAJLANDËS MBI HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Mbretërisë së Tajlandës (referuar më poshtë si “Palët”),

Nisur nga dëshira për të lehtësuar hyrjen, daljen dhe lëvizjen pa viza të qytetarëve të tyre, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit,
kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

1. Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit të Republikës së Shqipërisë nuk do të paraqesin kërkesa për hyrje, dalje, kalim transit ose qëndrim në Mbretërinë e Tajlandës për një periudhë jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë nga data e hyrjes së tyre, me kusht që ata nuk do të merren me ndonjë veprimtari, qoftë vetëpunësim ose me ndonjë aktivitet tjetër privat në Mbretërinë e Tajlandës.

2. Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit të Mbretërisë së Tajlandës nuk do të kenë nevojë për vizë për hyrje, dalje, kalim transit ose qëndrim në Republikën e Shqipërisë për një periudhë jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë nga data e hyrjes së tyre, me kusht që ata nuk do të merren me ndonjë veprimtari, qoftë vetëpunësim ose me ndonjë aktivitet tjetër privat në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

1. Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit të Mbretërisë së Tajlandës, që janë në përbërje të misioneve diplomatike ose konsullore të Mbretërisë së Tajlandës, ose janë



përfaqësues të Mbretërisë së Tajlandës në ndonjë organizatë ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit të Mbretërisë së Tajlandës, mund të hyjnë, të qëndrojnë dhe të largohen nga Republika e Shqipërisë pa marrë viza për një periudhë jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë. Periudha të tilla, me kërkesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Tajlandës ose të Ambasadës së Tajlandës në Romë, mund të zgjatet deri në fund të detyrës së tyre.

2. Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit të Republikës së Shqipërisë, që janë në përbërje të misioneve diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë ose janë përfaqësues të Republikës së Shqipërisë në ndonjë organizatë ndërkombëtare në Mbretërinë e Tajlandës, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit të Republikës së Shqipërisë, mund të hyjnë, të qëndrojnë dhe të largohen nga Mbretëria e Tajlandës pa marrë viza për një periudhë jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë. Periudha të tilla, me kërkesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë ose të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Kuala Lumpur, mund të zgjaten deri në fund të detyrës së tyre.

Neni 3

Mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit, që u jepet e drejta të përjashtohen nga vizat sipas dispozitave të nenit 1 dhe 2 të marrëveshjes, mund të hyjnë, largohen ose kalojnë transit në territorin e Palës tjetër në çdo vendkalim kufitar të caktuar për trafikun ndërkombëtar, me kusht që ata të respektojnë ligjet dhe rregullat e palëve përkatëse që rregullojnë hyrjen, udhëtimin dhe qëndrimin e të huajve.

Neni 4

1. Mbajtësit e pasaportave diplomatike apo të shërbimit do të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e palës tjetër gjatë qëndrimit në territorin e asaj Pale.

2. Kjo marrëveshje nuk do të kufizojë të drejtën e Palëve për të refuzuar hyrjen ose të anulojë qëndrimin për një qytetar të Palës tjetër, të cilin ajo e konsideron një *person non grata*.

Neni 5

1. Me synimin për të mbrojtur sigurinë kombëtare, rendin dhe qetësinë publike, dhe shëndetin e qytetarëve të tyre, secila Palë mund të pezullojë zbatimin e kësaj marrëveshjeje pjesërisht ose plotësisht.

2. Palët do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën për zbatimin ose anulimin e një mase të tillë nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 6

1. Palët do të shkëmbejnë specimenet e pasaportave të tyre përkatëse të vlefshme diplomatike dhe shërbimi, të paktën 30 ditë para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Në rastin e futjes në qarkullim nga secila Palë e pasaportave të reja diplomatike apo shërbimi, secila Palë do të njohë Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike me specimenet e pasaportave të reja, të paktën 30 ditë para nxjerrjes së tyre në qarkullim.

Neni 7

Çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet miqësisht me konsultime apo negociata midis Palëve.

Neni 8

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë nga data e njoftimit të fundit me shkrim nga Palët të përfundimit të procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

2. Kjo marrëveshje do të jetë e vlefshme për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila Palë mund ta anulojë këtë marrëveshje në çdo kohë, duke i dërguar njoftim me shkrim Palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Anulimi do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë (90) ditë nga data e marrjes së këtij njoftimi nga ana e Palës tjetër.

3. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet apo modifikohet me marrëveshje të përbashkët me shkrim të Palëve.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar për këtë rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, e kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në Nju-Jork, më 27 shtator 2013, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 16 lekë